



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:169788

Datë: 13.10.2020

Numri i dokumentit: 01185045

**PKR.nr.120/19**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN** - Departamenti për Krime të Rënda, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: Islam Thaçi, kryetar, Agim Ademi dhe Naser Maliqi, anëtarë, me Zyrtaren ligjore, Zahide Regjepi, porcesëmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit G. S, për veprën penale, posedimi i papauroizuar i narkotikëve, substacave psikotrope ose analgore nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 275 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.I.nr.122a/2019, të datës 20.08.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datën, 01.10.2020, publikisht shpalli, ndërsa më 06.10.2020 hartoi këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I pandehuri** G. S, nga babai M. dhe nëna F. , e lindur A, i lindur medaren ... në Viti , Komuna e Vitisë , ka të kryer shkollën e mesme, i papunësuar, i pa martuar, i gjendjes së varfër ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

## **ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë 13.07.2019 , rreth orës 01:30 minuta, K.e Vitisë, përball shkollës së mesme, i pandehuri pa autorizim posedon narkotikë, substanca narkotike apo analoge, në atë mënyrë që policia e kanë vërejtë një veturë të markës ... ngjyrë e zezë me targa..., dhe kanë parë se brenda ka persona dhe me rastin e kontrollimit fizik tek i pandehuri G. është vërejtë se nga dora e djathtë ka hedh në tokë e që ishte një cigare (joit) 1.0gr, dhe më pas gjatë kontrollimit të

veturës është gjetë një qese me substancë narkotike e llojit “Marihuanë”, 9.4 gr, të cilën e kishte fshehur më parë në veturën e tij, e cila i konfiskohet nga Policia e Kosovës DHTN në Gjilan.

Me çka ka kryer veprën penale, posedim i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitën e sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4, 7, 17, 38, 39, 40, 42, 69, 70, 71, dhe 72 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin, e

## G J Y K O N

Me dënim me burgim më kohëzgjatje prej 180 ditëve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjygjësor në shumën prej 50€ si dhe shumën prej 50€, në emër të taksës për kompenzimin e viktimave të krimit.

Të akuzuarit i konfiskohet substanca narkotike e llojit ”marihuana”, në peshë prej 9.4 gr, e cila duhet të shkatërrohet- asgjësohet, konform dispozitave të ligjit në fuqi.

## A R S Y E T I M

### **1.Rrjedha e çështjes**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, me datë 21.08.2019, ka ngritur aktakuzën, PP.I.nr.122a/2019, kundër të akuzuarit G. S, për veprën penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 275 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të KPRK-së.

Gjykata me datë 20.01.2020, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë prezentuar: prokurori shtetit, Shaban Spahiu, i pandehuri G. S, si dhe mbrojtësi, av.Mustaf Nuhiu nga Gjilani, i caktuar sipas detyres zyrtare.

Meqenëse në seancën e shqyrtimit fillestar i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të çështjes, nuk e ka pranuar fajsinë, kryetari i trupit gjykues të pandehurin përkatësisht mbrojtëin e tij e ka njoftuar që mund të paraqesin kundërshtimet lidhur me provat e cekuara në aktakuzë si dhe kërkesen për hudhjen e aktakuzës.

Në afatin e percaktuar ligjorë, mbrojtësi i të pandehurit, av. Mustaf Nuhiu me datë 03.02.2020, ka paraqitur kërkesë për kundërshtimin e provave dhe hudhjen e aktakuzës .

Prokurori i shtetit ndaj të njejtave me datën 07.02.2020, është pergjegjur me shkrim, duke kërkuar nga gjykata që ta refuzoj kërkesen për kundërshtimin e provave si dhe kërkesen për hudhjen e aktakuzës, nga fakti se aktakuza është e mbështetur në prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë, se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata me datën 03.03.2020 me aktvendimin, PKR.nr.120/19, ka refuzuar kërkesen e mbrojtësit të të pandehurit për kundërshtimin e provave dhe hudhjen e aktakuzës si të pabazuar.

Gjyaktat e Apelit të Kosovës me datën 02.06.2020, me aktvendimin, PN.nr.286/20, poashtu ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit G. S av.Mustafë Nuhiu si të pabazuar.

Gjykata me datën 01.10.2020, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën kanë prezentuar prokurori i çështjes, i pandehuri dhe mbrojtësi, av.Mustaf Nuhiu i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Kryetari i trupit gjykues e ka njoftuar të akuzuarin me të drejtat e tij, në kuptim të nenit 323 të KPPRK-së dhe pas leximit të aktakuzës i njejtë ka deklaruar , nuk e pranoj fajsinë për veprën penale , e cila më vëhet në barrë, nga fakti se substanca narkotike nuk ka qenë e imja, por e F. I.

Megjense i akuzuari nuk e ka pranuar fajsinë, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me procedurën e provave.

## **2.Provat e administruara**

Gjendjen faktike të cekur si më lart , gjykata e vërtetoi duke u bazuar në këto prova: Raporti fillestar i incidentit, raporti i oficerit, raporti i hetuesit shtesë të datës 09.08.2019, formuali pronë, formuali për konfiskimin e sendeve, raporti nga testi fushor, si dhe fotodokumentacioni i bashkangjur shkresave të lëndës.

**I akuzuari** G. S, ka deklaruar: në ditën kritike kur ka ndodhur rasti, unë nuk kam poseduar substancë narkotike, por të njejtat i ka blerë F. I në Prishtinë, sepse edhe unë kam qenë me të, por nuk e di se nga kushë i ka blerë.

Me rastin e kontrollit nga ana e policies, është e vërtetë se ata e kanë gjetë drogën në veturë , te siguresat para karrikes së shoferit, por unë nuk e kam ditë se F. aty e ka fshehur drogën. Unë nuk jamë perdorues i drogës. Arasyeja pse unë e kam pranuar këtë vepër penale si në polici, ashtu edhe në prokurori, ka qenë për shkak se F. mua më ka thënë se pranoje ti këtë vepër, ndërsa unë t'i paguaj dënimet se mua m'i prishin letrat.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit se në ditën që keni dhënë deklaratë në prokurori, a keni pasur avokatë?, i akuzuari pergjigjet: nuk kam pasur avokatë.

Në ballafaqimin e bërë nga prokurori i shtetit me deklaratën e të akuzuarit të dhënë në prokurori me datën 19.08.2019 edhe atë duke i'a prezentuar, procesverbalin faqen e parë edhe të dytë ku figuron edhe emrin i av.Mustaf Nuhiu , i akuzuari deklaroi se është e vërtetë që ka qenë edhe avokati. Në vazhdim të deklaratës së tij i akuzuari ka deklaruar se unë F. I e njoh ,sepse e kam bashkfashtarë, ngase ai më parë është marrë me drogë, i cili më herët ka jetuar në Zvicër, por edhe tani jeton atje. Unë atë nuk e kam pasur shok por e kam ditur që merret me drogë kështu që vitin e kaluar jemi njoftuar me të. Në ditën kritike F. ka ardhur dhe më ka marrë në shtëpi ,ora ka qenë diku 12 e ditës ,ka qenë vetë me kerr ,pastaj kemi shkuar në Gjilan dhe në Prishtinë për me marrë drogë, kështu që ai e ka blerë drogen të cilin ja ka nxënë policia. Kur kemi shkuar ne Prishtinë, unë kam qëndruar në veturë te Pompa e benzines në ..., ndërsa F. ka dalë nga vetuara dhe diku pas gjysmë ore është kthyer dhe e kam parë që ka blerë drogë, të cilën e ka fshehur te kapaku i drogës së benzines, dhe pjesën tjetër te siguresa , para ulses së shoferit. Prej Prishtinës jemi kthyer për në Gjilan në drejtim të fshatit tonë, dhe F. është ndal te ..., aty jemi kthyer në lokal dhe kemi qëndruar gjysmë ore, F. ka pirë birrën, ndërsa unë kam pirë lang.Nga aty kemi shkuar me ble bukë, aty ka qenë ora 1 pas mesnate, ku na ka ndalë policia, ne ishim duke pritur bukën të cilën e kishim porositur. Në momentin kur na kanë zënë policia, unë e kamë pasur cigaren dhe birrën në dorë, jam munduar me gjujtë, por këtë e kanë parë edhe policia, ndërsa drogën tjetër që ishte te siguresa, policia vet e kanë gjetë. Në pyetjen e prokurorit të shtetit se më parë a keni qenë përdorues i narkotikëve, i akuzuari është përgjegjur: unë më herët kamë qenë përdorues i narkotikëve, ndërsa tani jo, unë kam qenë përdorues i Marihuanës edhe atë gjatë kohës kur F. ka ardhur prej Zvicres, diku 2 muaj kam qenë përdorues, por vetë nuk kam blerë drogë, e kamë marrë nga shokët, emrat e të cilëve nuk më kujtohen.

Eshtë e vërtetë se unë kur kamë dal me F.,ai më ka dhënë drogë ,edhe atë Marihuanë,por unë Sh.R dhe Sh.1 nga Prishtina nuk i njoh. Është e vërtetë që unë i kam dy teze, të cilat janë të martuara në Gjilan, por emrat dhe mbiemrat e fëmijëve të tyre nuk i'a di, sepse nuk shkoj kurrë te to.

Prokurori i shtetit të akuzuarin e ballafaqon me pjesën e deklaratës së tij të dhënë në polici me datë 13.07.2019 edhe atë në faqen e tretë , ku keni thënë “Sh. R i cili jeton në Prishtinë e kamë djalë të tezes. Cila është e vërteta që ne deklaratën tuaj sot deklaroni se nuk e njef personin me emrin Sh. R,si dhe nuk u'a din emrat e djemëve të tezes,ndërsa në deklaratën e lexuar del se njëri nga ta është djali i tezes edhe atë Sh. R. i akuzuari deklaroi se deklarata e dhënë në polici është rrenë, ndërsa e vërteta është atë të cilën e kamë deklaruar sot në gjykatë .

Poashtu prokurori shtetit të akuzuarin e ballafaqon edhe me pjesën tjetër të deklaratës së tij, ku thuhet ”se unë jam përdorues i drogës qe gjashtë muaj, ndërsa sot deklaroni se keni qenë përdorues vetëm dy muaj, i akuzuari përgjigjet: Unë vetëm dy muaj e kam përdorur drogën e ndoshta edhe më pak.

### **3.Prokurori i shtetit Isuf Sadiku në fjalën përfundimtare ka deklaruar:**

Mbetem në tërsi pranë aktit akuzues, ngase edhe në shqyrtimin e sotëm gjyqësor, është vërtetuar pa medyshe se i akuzuari e ka kryer veprën penale që i vëhet në barrë, ngase aktakuza mbështetet në provat siq janë : raporti i oficerit, raporti hetues shtesë i datës 09.08.2019, formulari pronë, formulari për konfiskimin e sendeve, raporti nga testi fushor, fotodokumentacioni i bashkangjitur shkresave të lëndës si dhe nga vetë deklaratat e të akuzuarit G. S, i cili në fazën e hetimeve e ka pranuar veprën penale.

Andaj, i propozojmë gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj në pajtim me ligjin në fuqi. Me rastin e matjes dhe lartësisë së dënimit i propozojmë gjykatës që të ketë parasyshë rrethanat lehtësuese , por edhe ato rënduese, ndërsa sasia e drogës si në dispozitiv të aktakuzes të konfiskohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit G. S, av.Mustafë Salihu deklaron: gjatë shqyrtimit gjyqësor, nga provat me të cilat është mbështetur aktakuza e prokurorisë , vlersojmë se nuk është vërtetuar se i akuzuari të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Në dispozitiv të aktit akuzues, është konsatuar që substanca narkotike, është gjetur në veturën e tani të akuzuarit, fakti se vetuara është pronë e të akuzuarit ,nuk është e argumentuar nga ana prokurorisë, ngase i akuzuari ka qenë vetëm pasagjerë në këtë veturë. Sa i përket pranimin të fajsisë nga ana e të akuzuarit, gjatë zhvillimit të procedurës hetimore në këtë shqyrtim është vërtetuar që pranimi i fajsisë nga i njëjti nuk është bërë duke u mbështetur në faktet reale të treguara në deklaratën e dhënë në polici dhe prokurori, por ky pranim i fajsisë është bërë me qëllim që i akuzuari ta mbrojë personin F. I , nga e vërteta se i njëjti ka qenë posedues i substances narkotike të gjendur në veturën e tij.

Motivi i pranimin të fajsisë nga ana e të akuzuarit, ka qenë duke u bazuar në faktin se personi F. I , i ka premtuar të akuzuarit se do të kujdeset që i njëjti të shpëtoj nga ndjekja penale, gjegjësisht dënimi eventual, dhe se i akuzuari është shfytëzuar nga personi F., duke e marrë parasysh moshën e tij dhe gjendjen ekonomike të të akuzuarit në fjalë. Andaj, nga të lartëcekurat i propozojmë gjykatës që të marrë aktgjykim liruës, sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar se i akuzuari ta ketë kryer veprën penale në fjalë .

I akuzuari G. S, ka deklaruar: në tërsi e mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit dhe se nuk kamë qka të shtoj.

### **4.Konstatimet e gjykatës**

Gjykata pas administrimit të provave sa i përket veprës penale, posedim i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.1 lidhur të Kodit penal të Republikës së Kosovës, gjeti se i akuzuari në deklaratat e tij të dhënë në polici me datën 13.07.2019 dhe në prokurori me datë 19.08.2019 në prezencën e mbojtësit av. Mustaf Nuhui, e ka pranuar fajsinë për veprën penale e cila i vëhet në barrë nga oragni akuzes. Ndërsa i akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se deklarata e dhënë në polici dhe në prokurori ka qenë rrenë, duke u arsyetuar se pranimin e fajsisë për veprën penale e cila më vëhet ne barrë, e kam pranuar në polici dhe prokurori me arsyetimin se pronari i automjetit F. I ,më ka bindur që ta pranoj fajsinë për këtë vepër penale, ndërsa ai do t'a hjek dënimin , krejt me qëllim që atij mos ti prishen letrat ,sepse jeton ne Zvicer . Edhe në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 01.10.2020 , i akuzuari ka deklaruar se edhe më parë ka qenë përdoues i substancës narkotike marihuanë edhe atë duke thënë herë dy muaj e herë gjashtë muaj, ndërsa sa i përketë faktit se ditën kritike ka shkuar tek shtëpija e tij, F. I dhe e ka marrë me veturen e tij të llojit "... “ ngjyrë e zezë me targa të regjistrimit ..., pastaj me të njejtin kanë shkuar në Prishtinë, duke përshkruar saktësisht vendin gjegjësisht në Prishtinë”, ku edhe kishe dalur F. prej veturës dhe pas një gjysmë ore është kthyer, duke e parë atë se kishte blerë substancën narkotike të llojit marihuanë, e që një pjesë të saj e kishte fshehur tek siguresa perballë ulses së tij të automjetit, ndërsa një pjesë te kapaku i benzinës së automjetit në fjalë.

Po ashtu i akuzuari në deklaratën e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor, ka pohuar me saktësi se F. I e njeh nga fakti që është bashkfsharë i tij, por njëkohësisht ka deklaruar se e ka ditur që është përdoues i drogës, dhe se gjatë qëndrimit me të është fornizuar nga i njejtë me drogë në mënyrë shoqërore. Në ballafaqimin e deklaratave të tij të dhënë në polici dhe prokurori nga ana e prokurorit të shtetit , gjykata erdhi në përfundim se deklaratat e tija të dhënë në polici dhe në prokurori janë të vëreta e njëkohësisht edhe bindëse për gjykatën, sepse i akuzuari me vetëdije , ka pranuar veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza, ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari edhe perkundër faktit që nuk e ka pranur fajsinë, duke pohuar se substanca narkotike e sekuestruar natën kritike nuk ka qenë e tij, por e F. I, gjykata nuk ja fali besimin sepse mospranimi i fajsisë në shqyrtimin gjyqësor bëhëj nga i njejtë me qëllim të shmangijes së përgjegjësis penale dhe fajsisë.

Gjykata nuk ja fali besimin mbojtjes së të akuzuarit, gjegjësisht deklaratës së dhënë në shqyrtimin gjyqësor edhe për faktin se deklarata e tij ishte jo kredibile, e cila nuk përputhej me kronologjinë dhe përmbajtjen e së njejtës, ngase i akuzuari në deklaratat e tija të dhëna në porcedurën parapenale, herë ka thënë që kamë qenë përdoues i droges dy muaj , e herë gjashtë muaj, pastaj herë ka deklaruar se nuk e kamë ditur se ku është fshehur droga nga Fatmi Idrizi , e herë thonte se nuk e kam ditur se pse F. I. ka dal prej vetures në Prishtinë, dhe se nuk e kamë dite se ku ka shkuar, në anën tjetër poashtu kishe deklaruar se nuk ja

di emrat e fëmijëve të tezes, gjë që ishte e pakuptimtë dhe e palogjikshme , ngase i akuzuari saktësisht ka deklaruar në polici se Sh.R e ka djalë të tezes me të cilin janë takuar te Bregu i Djellit në Prishtinë, derisa në shqyrtim gjyqësor deklaroi të kundërtën, se nuk e njeh të njejtin, pra këto deklarata të tij ishin kundërtënjese njëra me tjetrën.

Në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari vetë e ka pranur faktin se me të ndalur nga ana e Policisë , ku ishin duke pritur në veturë, sipas tij me qëllim të marrjes së bukes, të cilën më parë e kishin porositur, gjatë kontorllës së policisë , të njejtin e kanë vërejtur duke hudhur nga dora në tokë, nga ana e djathët cigaren e llojit (joit)1.0gr, fakt këtë të cilin i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e pranon, por e arsyeton se F. I me të vëretë atë, ja kishte lëshuar në dorë, ndërsa pjeseën tjetër sipas të akuzuarit policia pastaj e kishin gjetur tek siguresa brenda veturës, perballë ulses së shoferit. Nga deklaratat e dhëna në hetuesi, por edhe në shqyrtimin gjyqësor, gjykata erdhi në përfundim që i akuzuri ka qenë përdorues i substancës narkotike marihuanë, të cilën e ka marrë nga F. I dhe se natën kritike, substanca narkotike e sekuestruar nga ana e policisë, është gjetur tek i akuzuari në fjalë, të cilin i njejtin ka shkuar dhe e ka marrë në Prishtinë në vendin dhe te personi i caktuar, Sh. R, të cilin e njohte nga fakti se ishte djali i tezes së tij.

Në fund gjykata pas shqyrtimit dhe administimit të provave bëri edhe rikualifikimin e veprës penale, posedimi i papauzoizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analgore nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 275 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.I.nr.122a/2019, të datës 20.08.2019, në veprën penale, posedim i papautorizuar i narkotikëve , substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së, sepse në dispozitivin e aktakuzës, thuhet se vepra penale është kryer më 13.07.2019, rrethë orës 01:30 , K.e Vitisë, perballë shkollës së mesme, e që sipas nenit 275 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të KPRK-së , thuhet se nëse vepra është kryer brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash ,nga shkolla apo mjedisi tjetër që përdoret edhe nga fëmijët ose brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga cilido institucion i edukimit , kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet, e që në rastin konkretë, gjykata konsideron se data 13.07.2019, kur është kryer vepra penale, shkollat nuk kanë punuar, e poashtu edhe po të shikohet ora 01:30,nënkuptohet se ka qenë natë dhe se nuk ka pasur nxënës e as fëmijë gjatë kësaj kohe. Prandaj, duke marrë parasysh faktin se shkolla në natën kritike nuk ka punuar dhe poashtu duke pasur parasysh edhe orën, gjegjësisht mesnatën,kur edhe është kryer vepra penale,fakt ky i cili nuk mund të ndërlihet vetëm me perimetrin, përkatësisht distancën nga shkolla në vendin ku është ndodhur automjeti, përkatësisht kryerësi i veprës penale, andaj bëri rikualifikimi i veprës si në dispozitiv të aktgjykimit.

## **5.Gjendja faktike e vërtetuar**

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari G. S, në kohën dhe vendin e përshkruar si në aktakuzën, PP.nr.122a/20129 të datës 20.08.2019, ka kryer veprën penale, posedim i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.1 lidhur të Kodit penal të Republikës së Kosovës, për çka është penalisht përgjegjës dhe fajtor, andaj të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoi me dënim me burgim më kohëzgjatje prej 180 ditëve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **6.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, si rrethanë rënduese për të akuzuarin, gjykata pati parasysh, shkallën e përgjegjësisë penale, dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale ndërsa si rrethamë lehtësuese për të akuzuarin, gjykata pati parasysh faktin se i njëjti në kohën e kryerjes së veprës penale, ka qenë i moshës relativisht të re, përdorus i substancave narkotike të llojit marihuanë, i papunuar dhe i gjendjes së varfër ekonomike.

## **7.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar**

Gjykata ka ardhur në përfundim së dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit, duke i marrë parasysh rrethanat e lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Gjykata po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

## **9.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1e lidhur me nenin 450 paragrafi 1 dhe 2 nenparagrafi 2.6 të KPP-ës, ka vendosur që të akuzuarin t'ia detyrojë t'i paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (pesëdhjetë) Euro,dhe shumën prej 50€ (pesëdhjetë) Euro,në emer të taksës për kompensimin



e viktimave të krimit në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti Për Krime të Rënda  
PKR.nr.120/19, më 06.10.2020**

**Zyrtare ligjore**  
Zahide Rexhepi

**Kryetari i trupit gjykues**  
Islam Thaçi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.